

Për:	Operatori Ekonomik: "G-PROJECT" Sh.p.k. me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	30.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: 29.03.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "G-PROJECT" Sh.p.k. me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTIT PËR "QENDRA PËR ARTE, KULTURË DHE INOVACION"**, me Numër të prokurimit: 623-20-7592-4-2-3, Nr. i brendshëm: 623-19-064-4-2-3, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: "G-PROJECT" Sh.p.k. me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTIT PËR "QENDRA PËR ARTE, KULTURË DHE INOVACION"**, me Numër të prokurimit: 623-20-7592-4-2-3, Nr. i brendshëm: 623-19-064-4-2-3, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: 26.03.2021, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **HARTIMI I PROJEKTIT PËR "QENDRA PËR ARTE, KULTURË DHE INOVACION"**, me Numër të prokurimit: 623-20-7592-4-2-3, Nr. i brendshëm: 623-19-064-4-2-3.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: “G-PROJECT” Sh.p.k. me adresë në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTIT PËR “QENDRA PËR ARTE, KULTURË DHE INOVACION”**, me Numër të prokurimit: **623-20-7592-4-2-3**, Nr. i brendshëm: **623-19-064-4-2-3**, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: **26.03.2021**, të publikuar në web-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 29.03.2021, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje lidhur me Nenin 62 të LPP-së, duke cekur:

Arsyetimi i Komunës për anulim të tenderit nuk ka bazë ligjore për anulim. Edhe pse AK ka cekur në njoftimin për anulim se Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, në arsyetim nuk ka cekur asnjë dispozitë të LPP-së. Me vendimin për anulim të tenderit AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së i cili parasheh se kur mund të anulohet një aktivitet i prokurimit:

Ligji i Prokurimit Publik në Nenin 62 ka paraparë:

[Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit]

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Në njoftimin mbi Vendimin e AK, qartazi shkruan se tenderi i dorëzuar nga G- Project është i vetmi projekt që i plotëson kriteret teknike dhe administrative.

jepni një vlerësim se projekti ideor detal i dorëzuar nga Kompania: "G – PROJECT" Sh.p.k. – Prizren, i cili nga Juria Profesionale ka marrë pikët totale: 77.26 pikë, projekti ne fjale a mund te pajiset nga Drejtoria e juaj me leje ndërtimore dhe a i përmbushë kushtet urbanistike për zbatimin e planit hapësinor, planin urbanistik, sepse ky është projekti i vetëm i përgjegjshëm teknikisht dhe administrativisht sipas Ligjit të Prokurimit Publik, me kushte që të shpërblehet si një tërësi e përgjegjshme kontraktuale.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Sa i përket pretendimit për shkelje të këtyre Neneve, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues e ka respektuar plotësisht Nenin 62, andaj ky pretendim i juaj ankimor i pabazuar, duke dhënë arsyetimet si në vijime:

Neni IV.3) Arsyeja për anulimin e procedurës së prokurimit publik, bëhet nëse plotëson njëra nga dispozitatë të më poshtë cekura, që bëhen pas hapjes së tenderit:

IV.3) Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik:

Pas hapjes së tenderëve

- ☐ Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit;
- ☒ Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;
- ☐ Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në mase substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;

Para hapjes së tenderëve

- ☐ Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Ne si AK në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, jo vetëm që kemi cekur dispozitën e Ligjit:

Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, por kemi bashkangjitur dhe sqarimin për arsyen e Anulimit sipas RrUOPP-së:

Rezultati i aktivitetit të prokurimit për propozim teknik është:

Autoriteti Kontraktues KOMUNA E RAHOVECIT ANULON aktivitetin e prokurimit:

- Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit;
Neni 44.7 pika ii e RRUOPP-se: (ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

Gjithashtu në vijim secilit Operator Ekonomik i janë bashkangjitur arsyet e eliminimit duke ju përfshirë edhe juve:



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ¹

Autoriteti i Kontraktues: Komuna e Rahovecit

Emri dhe adresën e tenderuesit: "G – PROJECT" Sh.p.k. me seli në Prizren

Data: 26.03.2021

Nr. i prokurimit:	623-20-7592-4-2-3
Nr. i brendshëm	623-19-064-4-2-3

Titulli: HARTIMI I PROJEKTIT PËR "QENDRA PËR ARTE, KULTURË DHE INOVACION"

I ndëruar (a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIMI:

Tenderi i juaj është administrativisht e papërgjegjshme:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas Kushteve dhe Kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

- Tenderi juaj refuzohet në bazë të Kërkesës të bërë nga Komisioni për ri-vlerësimin e ofertave me Vendim Nr. 150, i datës: 09.03.2021, për Drejtorin e Urbanizmit, përmes Zyrës së Prokurimit, ku me datë: 18.03.2021, kemi marrë përgjigje nga Drejtoria për Urbanizëm *(i gjeni te bashkangjitur Sqarimet)*

Nëse besoni se Autoriteti i Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashitoni ankese pranë Autoritetit të Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt
Astrit Mullabazi
Zyrtari i Prokurimit


(Nënshkrimi)

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje, duke cekur: AK na ka eliminuar pasi sipas Drejtorisë së Urbanizmit projekti ynë ideor tejkalon përqindjen e shfrytëzimit të parcelës. Komuna thotë se sipas detyrës projektuese shfrytëzimi i parcelës është 40%, ndërsa projekti ynë e ka 70%. Komuna pikërisht nuk ka vlerësuar tenderin sipas detyrës projektuese pasi askund në këtë dokument nuk shënon se sa është koeficienti i shfrytëzimit të parcelës. Drejtoria e Urbanizmit gabimisht vlerëson që kriteri 40% ka qenë pjesë e detyrës projektuese, e që në fakt nuk ka qenë pasi në këtë dokument askund nuk përmendet përqindja e shfrytëzimit të parcelës.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Sa i përket pretendimit për shkelje, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues i ka respektuar plotësisht kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Konkurse, kështu që pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, me arsyetimet si në vijim:

Me datë: 04.12.2020, është kërkuar sqarim nga Operatori Ekonomik, i cili sqarim është përcjellë tek të gjithë Operator Ekonomik, sipas Nenit 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit:

Paragrafi 1: Gjatë përgatitjes së tenderit, çdo operatorë ekonomik mund të bëjë kërkesë me shkrim te autoriteti përkatës kontraktues për çfarëdo informate apo sqarim shtesë që operatori ekonomik beson se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një tenderi përkatës, me kusht që çdo kërkesë e tillë me shkrim të pranohet nga autoriteti kontraktues:

Paragrafi 6: Nëse autoriteti kontraktues konstaton se ndonjëra nga informatat e kërkuara sqaruese ose plotësuese e cila kërkohet nga operatorët ekonomik për kontraktim është e domosdoshme për ta, autoriteti kontraktues menjëherë dhe në të njëjtën kohë siguron informata me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, të gjithë operatorëve ekonomik, që kanë marrë ose kanë pranuar nga autoriteti kontraktues dosjen e tenderit përkatës ose stesën për tenderim. Autoriteti kontraktues nuk do të zbulojë identitetin e operatorit ekonomik që i ka kërkuar informatat sqaruese. duke sqaruar si në vijim këtë kërkesë:

Pyetje nga OE: A ka informata per profilet e rrugeve rrethuese, distancat, vija ndertimore, shtrirja e nderteses etj

Përgjigje nga Zyra e Prokurimit: Për shkakë të mungesave të planeve rregulluese profilet e rrugeve nuk janë të definuara, por duhet ti përshtaten gjendjes ekzistuese dhe normave teknike të planifikimit. Po ashtu vija e kuqe në situacion të miret si vi rregulluese e pacelës, kurse distanca në mes të vijës rregulluese dhe asaj ndërtimore nuk mund të jetë më e vogël se 200cm. Shfrytëzimi max I parcelës për ndërtim është 40% .

Sqarim i dosjes së tenderit

Versioni i tanishëm: 04.12.2020 15:21 Sqarim nga A.K. Komuna e Rahovecit - Hartimi i projektit per Qendra për Arte, Kulture dhe Inovacion...docx

Hape:

Shikarke te gjithe dokumentacionin

Versionet

Shqip

Në bazë të këtij sqarimi, përgjigja nga AK-ja bëhet Obligative për të gjithë Operatorët Ekonomik.

Sa i përket komisionit të ri-vlerësimit, të gjithë anëtarët e Komisionit janë të përzgjedhur si ekspertë të fushës për të vlerësuar kërkesat e dosjes së tenderit ashtu siç kërkohen nga Ligji:

Neni 40. Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të tenderëve,

Paragrafi 40.5: *Numri i anëtarëve të komisionit vlerësues do të varet nga vlera dhe kompleksiteti i aktivitetit të prokurimit, por në të gjitha rastet do të përbëhet nga jo më pak se (3) tre dhe numri gjithnjë do të jetë tek. Komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit. personat të cilët kanë qenë anëtarë të komisionit për hapje të ofertave mund të jenë anëtarë të komisionit vlerësues. (RrUOPP-së)*

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve:

Paragrafi 1: *Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion detyësor lidhur me këtë çështje.*

Paragrafi 2: *Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.*

Paragrafi 4: *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. (LPP-së)*

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje, duke cekur:

Në detyrën projektuese është përshkruar lokacioni dhe zona e projektit si mëposhtë:

"Në anën perëndimore dhe jugore parcela është e rrethuar me ndërtesa të banimit. Etazhiteti i ndërtesave të cilat rrethojnë parcelën arrin deri në P+2" i vendosur të gjitha sipërfaqet e hapësirave sipas kërkesave dhe është arritur forma e objektit, duke respektuar zonën e projektimit me harmonizimin e etazhitetit të zonës përreth, pra B+P+2. Propozimet nga OE të tjerë janë ngritur në etazhitet duke krijuar disproporcion me situatën dhe etazhitetin e zonës.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Sa i përket pretendimit për shkelje, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues i ka respektuar plotësisht kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Konkurse, kështu që pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, pasi që asnjë Operator nuk është shpallur i përgjegjshëm.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje, duke cekur:

Projekt propozimi ynë është vlerësuar me poentim si vendi i dytë nga juria profesionale dhe e cila sipas kësaj jurie i ka plotësuar të gjitha kriteret teknike. Përndryshe nëse objekti do të binte ndesh me çfarëdo kriteri atëherë ai nuk do të vlerësohej me poentim por do të eliminohej. Sipas nenit 80.2 të LPP është juria profesionale ajo që vlerëson kriteret teknike. Zyra e Prokurimit së bashku me Komisionin e Ri-vlerësimit me pyetjen drejtuar Drejtorisë së Urbanizimit ka dalë

ndërhyrë në kompetencat e jurisë profesionale. Komisioni i Ri-vlerësimit është dashur që të vlerësojë ofertat vetëm nga pikëpamja administrative e jo të ndërhyjë në punën e jurisë profesionale. Sipas nenit 57.9 të Udhëzuesit, vendimi i jurisë është përfundimtar. Përderisa juria e ka vlerësuar projektin tonë ideor se i plotëson kriteret teknike, atëherë AK nuk ka të drejtë që të bëjë vlerësim të punës së jurisë profesionale.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

Sa i përket pretendimit për shkelje, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues i ka respektuar plotësisht kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Konkurse, kështu që pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, pasi që detyrë e Komisionit të vlerësimit është që të vlerësojë të gjitha kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit, ku në Dosje Kërkesë llogaritet edhe ato administrative edhe kërkesat teknike, me sqarimet e Ligjit si në vijim:

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve:

Paragrafi 4: *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. (LPP-së)*

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 5:

Komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar tenderin nga pikëpamja administrative sipas kërkesave të dosjes së tenderit. I njëjti komision ka dalë jashtë fushëveprimit të saj kur ka bërë pyetje tek Drejtoria e Urbanizmit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 5:

Vlen përgjigja Nr. 4 e pretendimeve

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 6:

Sipas nenit 57.34 të Udhëzuesit:

Nëse kandidati, projekti i të cilit radhitet si më i miri "i pari" nga Juria, nuk është i përgjegjshëm atëherë projektimi përkatës do të refuzohet dhe i dyti do të radhitet si më i miri "i pari".

Në këtë rast, projekti i radhitur si i pari nga juria nuk është i përgjegjshëm dhe tenderi i tij është refuzuar. Projekti ynë është i dyti me pikë nga juria, e që në këtë rast ashtu sic ka thënë Zyra e

~~Prokurimit, projekti nga G-Projekt është i vetmi i përgjegjshëm administrativisht dhe teknikisht.~~

Pra projekti ynë duhet të shpërblehet me kontratë sipas vlerësimit të komisionit të vlerësimit dhe jurisë profesionale.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 6:

Sa i përket pretendimit për shkelje, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues i ka respektuar plotësisht kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Konkurse, kështu që pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, pasi që kjo procedurë është me dy (2) faza dhe sipas formulës së caktuar tenderi i cili është i përgjegjshëm në të dy (2) fazat shpallet fitues, pra në rastin konkret nuk kemi asnjë Operator Ekonomik të përgjegjshëm.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 7:

Komuna e Rahovecit nuk e ka të miratuar Hartën Zonale ose Planin e hollësishëm urbanistik, përmes të cilit do të përcaktoheshin saktë kriteret urbane të kësaj zone dhe në këtë rast ato kriteret do të duhej të inkorporoheshin në dosjen e tenderit dhe detyrën projektuese. Më kryesorja është që ky projekt është ideor/konceptuar/fillestar dhe do të mund të modifikohet sipas kërkesave të AK, komunitetit artistik dhe diskutimeve në të ardhmen me Drejtorinë e Urbanizmit rreth idesë së ngritjes në etazhitete dhe kështu mund të ndryshohet projekti deri në arritjen e formës së prerë së përshtatshme për të gjithë. Në këtë frymë bashkëpunimi realizohen të gjitha Konkursat e Projektimit në Kosovë, pra pas shpalljes së fituesit krijohen grupe profesionale për avancimin e projektit i cili do të jetësohet.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 7:

Sa i përket pretendimit për shkelje, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues i ka respektuar plotësisht kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Konkurse, kështu që pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, për arsye se fraza juaj: **Në këtë frymë bashkëpunimi realizohen të gjitha Konkursat e Projektimit në Kosovë, pra pas shpalljes së fituesit krijohen grupe profesionale për avancimin e projektit i cili do të jetësohet** është vetëm një praktik, ndoshta që zbatohet në ndonjë AK, mirëpo nuk do të thotë që është në përputhje me kërkesat e ligjit

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 8:

AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP, pasi na ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me OE të rekomanduar më parë. Projekti i kompanisë së rekomanduarmë herët Urban Plus ka shfrytëzim të sipërfaqes 47% sipas llogaritjes sonë, ndërsa tani në mënyrë të paligjshme na eliminon neve për tejkalim të sipërfaqes së shfrytëzimit të parcelës. Komuna nuk ka vepruar njëjtë edhe me kompaninë Urban Plus, siç ka vepruar me projektin tonë. Pse komuna nuk ka bërë të njëjtën pyetje në Drejtorinë e Urbanizmit lidhur me projektin e Urban Plus, ndërsa për projektin tonë ka bërë pyetje?

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 8:

Sa i përket pretendimit për shkelje, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues i ka respektuar plotësisht kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Konkurse, kështu që pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, sepse ne bazë të Kërkesës tuaj për rishqyrtim, e kemi kthyer në rivlerësim, që do të thotë janë caktuar Anëtarë tjerë të komisionit, d.m.th. vlerësimi nisë nga pika zero. Kërkesa e parashtruar në Drejtorinë e Urbanizmit është parashtruar nga anëtar e Komisionit të Ri-vlerësimit bazuar në kërkesën për sqarim të datës: 04.12.2020.

Sqarim i dosjes së tenderit

Versioni i tanishëm: 04.12.2020 15:21 Sqarim nga A.K. Komuna e Rahovecit - Hartimi i projektit për Qendra për Arte, Kulturë dhe Inovacion.docx

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Versiohet

Shqip

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 9:

Projekti ynë i plotëson kriteret teknike dhe administrative, në përputhje me nenin 80 dhe 59 të LPP-së. Pra jura ka dhënë përfundimtar sa i përket kriterëve teknike dhe dy herë radhazi komisionet e vlerësimit kanë vlerësuar se jemi të përgjegjshëm nga ana administrative. Eliminimi ynë në këtë rast është arbitrar dhe nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 9:

Sa i përket pretendimit për shkelje, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues i ka respektuar plotësisht kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Konkurse, kështu që pretendim i juaj ankimor është i pabazuar.

Lexo përgjigjen PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 6

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 10:

Siç po vërehet nga këto që u thanë më lartë qëllimi i Autoritetit Kontraktues është që në asnjë mënyrë të mos na shpërblejë neve me kontratë. Herën e parë ka tentuar të shpërblejë me kontratë kompaninë që as për së afërmi si ka plotësuar kriteret, ndërsa tani në mënyrë të paligjshme shpik kritere vetëm për të na eliminuar. Duke marrë parasysh këtë ne nuk do të ndalemi me kaq pasi do t'i drejtohem edhe prokurorisë lidhur me këto veprime tendencioze të Komunës së Rahovecit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 10:

Sa i përket pretendimit për shkelje, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues i ka respektuar plotësisht kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Konkurse, kështu që pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, pasi që kjo procedurë është me dy (2) faza dhe sipas formulës së caktuar tenderi i cili është i përgjegjshëm në të dy (2) fazat shpallet fitues, pra në rastin konkret nuk kemi asnjë Operator Ekonomik të përgjegjshëm, gjithashtu duke marrë parasysh kërkesën tuaj për rishqyrtim kemi rivlerësuar këtë aktivitet, ku në çdo rast vendimi për caktimin e komisionit vlerësues bazuar në nenet e përshkruara në pretendimet e mësipërme nënkupton që anëtarët e komisionit janë persona kompetent për të vlerësuar aktivitetin në fjalë.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit